

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6946
E martë, 18 korrik 2023
Çmimi 0.40

"Bayraktarët" nuk do të mund të përdoren pa autorizimin e KFOR-it



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



KURTI PËR TË DYTËN HERË E REFUZON RAMËN




Për të dytën herë brenda pak ditësh kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka injoruar kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Herën e parë duke mos e pritur në Prishtinë, herën e dytë duke mos iu përgjigjur

ftesës së tij për takim informal në mes të liderëve të Ballkanit në Tiranë. Për mospjesëmarrjen e kryeministrit Kurti, Rama tha: "Nuk shoh asnjë interes se ishin gjithë të ftuar, kush deshi

erdhi, kush nuk mundi nuk erdhi". Opozita në Kosovë ka drejtuar kritika për Kurtin për mospjesëmarrjen në këtë takim, duke theksuar se ky është dezertim i politikës së jashtme të Kosovës

AKTUALE



IPHONE I VITIT 2007 SHITET 190 000 DOLLARË NË ANKAND F.2

KOSOVA FORMALIZON KËRKESËN PËR ANËTARËSIM NË OGP. KRASNIOI: ARRITJE JASHTË-ZAKONISHT E RËNDËSISHME F.3

ARBËR ZENUNI ZGJEDHET KRYESUES I KUVENTIT KOMUNAL TË RAHOVECIT F.6

EKONOMI



MINISTRI PEÇI: INSTITUTI BUJQËSOR PËR MË SHUMË SE NË JË DEKADË KA TJETËRSUAR TOKA, PRONA DHE BANESA F.7

MEHMETI KËRKON NGA PRESIDENCA QË TË MOS DEKRETOHET GOVERNATORI I RI I BOK-SË F.7

SPORT



NDAJ ZVËRËSË SYNOHET FITORJA, KËRKOHET PËRKRAHJE E TIFOZËVE F.10

OSMANI I INKURAJON VIKTIMAT E DHUNËS SEKSUALE GJATË LUFTËS TË APLIKOJNË PËR NJOHJE TË STATUSIT NË KOMISIONIN SHITETËROR F. PAGE 3



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR PROJEKTIN 'NDËRTIMI I URAVE PËRMES ARTIT DHE KULTURËS...' F. PAGE 6



RENOVA
PUTZ
Miqykat
Zhangjellë - Tiranë
Cërreç - Prishtinë
E-mail: renovaweb.net.mk
Tel: +386 44 487 332 | +386 44 487 100
+386 44 487 753
Fax: +386 44 487 333

PRINCESHA
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princeshatir.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYRKOL - BUNJAKOL - CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 070 | 045 500 070
045 500 070 | 049 500 070

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP BIL
PUNA SHKËRIM
Rruga "Rudina" Vranje, c/o Prishtinë, 10010, TIRANË
TIN 10010 POLISH CASE 507 FIA, 10010 POLISH 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net


INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

iPhone i vitit 2007 shitet 190 000 dollarë në ankand

Nju-Jork, 17 korrik - Zakonisht telefonet e kompanisë Apple e humbin vlerën në momentin që nxirren nga dyqani, por janë disa raste speciale, sikurse ajo e një ankandi në Shtetet e Bashkuara, ku një telefon i papapuri iPhone, i edicionit të parë, me memorie 4 gigabajt, është shitur për 190.372 dollarë. Në atë periudhë nuk janë prodhuar shumë telefona të tillë, duke e bërë atë tejet të veçantë për koleksionuesit e iPhone. Në garë për ta blerë telefonin

në fjalë kanë qenë 28 pjesëmarrës. Telefoni është shitur në ankand rreth 400 herë më shtrëngjtë sesa çmimi i tij original. I lëshuar për herë të parë më 2007 nga ish-udhëheqsi i kompanisë, Steve Jobs, Apple ka vendosur të heqë nga tregu këtë telefon me memorie 4 gigabajt për shkak të ngjecjeve në shiteje. Shumica e njerëzve kanë vendosur atëbotë ta blejnë versionin me memorie 8 gigabajt, i cili është lansuar në

po të njëjtën kohë. Shumë shpesh nëpër ankande shiten gjëra të ndryshme të Jobsit. Së fundi janë shitur disa poema që ai i ka shkruar në shkollë të mesme, fotografi të tij në kolegje dhe dokumente të tjera. Steve Jobs, bashkëthemelues i kompanisë Apple, ka vdekur më 2011, në moshën 56-vjeçare, nga kanceri në pankreas. Ai ia ka prezantuar botës produktet iMac, iPod, iPhone dhe iPad.



BE-ja i kërkon Maqedonisë së Veriut votimin e ndryshimeve kushtetuese

SHKUP, 17 KORRIK - Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian i kanë kërkuar Maqedonisë së Veriut t'i miratojë sa më shpejt ndryshimet kushtetuese për t'ua hapur rrugën bisedimeve për anëtarësim në bllokun evropian. Ky mesazh u është përcjellë autoriteteve maqedonase nga sekretarja shtetërore e Francës, Laurence Boon, ministria gjermane për Evropën, Anna Leermann dhe ministri polak për Evropën, Szymon Szynkowski.



Të zyratë të lartë të shteteve anëtare të BE-së, gjatë një vizite të hënën në Shkup, kanë thënë se procesi i anëtarësimit në BE nuk mund të nisë e as të përmbillet pa plotësimin e kushteve, para së gjithash ndryshimin e kushtetutës. Këto ndryshime duhet të bëhen për përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e saj, si popull shtetformues, astu siç parashihet me atë që njihet si "propozimi francez" për zgjidhjen e çështjeve të hapura të Maqedonisë së Veriut me Bullgarië. "Mesazhi i parë është se Maqedonia e Veriut i përket familjes së BE-së, e dyta është se vendimi tani është në duart e vendit tuaj, mesazhi i tretë është

se kjo lëvizje tani është e nevojshme për shkak të momentit që ekziston në BE. Nga Bullgaria nuk do të ketë kërkesa dhe kushte të reja pas përfundimit të ndryshimeve kushtetuese", ka thënë zyrtarja franceze Boon pas takimit që ka pasur me zëvendëskryeministrin maqedonas Bojan Mariçiq. Ministria gjermane e ka nisur dhe përfunduar fjalimin në

gjuhën maqedonase për t'i siguruar autoritetit maqedonase, në veçanti opozitën, se gjyha maqedonase nuk rrezikohet dhe njihet si e tillë edhe pas plotësimit të kushtit për përfshirjen e pakicës bullgare në kushtetutë. "Mesazhi ynë është i qartë - thelsojmë mbështetjen që Maqedonia e Veriut të bëhet anëtare e BE-së. Tani dritarja për zgjerimin e BE-

së është e hapur, gjë që kërkon përgjegjësi dhe mendim strategjik. Ne ju mbështesim që të vazhdoni në rrugën e reformës. Amendamentet kushtetuese do ta konfirmojnë rolin e Maqedonisë së Veriut si shtet multietnik dhe kështu vendi do të mund ta vazhdojë anëtarësimin. U bëj thirrje të gjitha subjekteve politike që t'i mbështesin ndryshimet kushtetuese. Çdo vonesë do të jetë në dëm të qytetarëve. Tani është koha për vendime, për përgjegjësi", ka thënë ministria gjermane për Evropën, Anna Leermann. Zyratë evropiane kanë thënë se "Maqedonia e Veriut duhet ta shfrytëzojë periudhën e turbullt gjopolitike për ta arritur synimin për integrim në BE". "Mesazhi ynë është i qartë - ne duam ta mbështesim Maqedoninë e Veriut në rrugën drejt BE-së dhe ta shohim atë si një anëtar të plotë. Tashmë u takon strukturave politike t'i përfundojnë ndryshimet kushtetuese. Duhet të jetë një vendim sovran i vendit. Tani është momenti, nuk ka kohë për të pritur, sepse shansi mund të humbet", ka thënë ministri polak Szynkowski.

Vizita e zyratëve të Francës, Gjermanisë dhe Polonisë vjen një javë pas atyre të Austrisë, Çekisë dhe Sllovakisë, të cilët, gjithashtu, përcojnë mesazhe për përmirësimin e kushteve për vazhdimin e bisedimeve me BE-në. "Pres që të gjitha partitë politike ta kenë prioritet vazhdimin e suksesit të vitit të kaluar. Të miratojmë ndryshimet kushtetuese, të mos kthehemi në sallën e pritjes, por të shkojmë përpara", ka thënë zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bojan Mariçiq. Por, pavarësisht prej mesazheve të tilla të diplomatëve evropianë, opozita maqedonase ka thënë se nuk do t'i mbështesë ndryshimet kushtetuese. Ato nuk mund të miratohen pa votat e deputetëve të VMRO DPMNE-së, pasi shumica parlamentare nuk i ka dytë atësi të votave të mjaftueshme në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut. VMRO DPMNE-ja është kundër këtyre ndryshimeve, me arsyetimin se me përfshirjen e pakicës bullgare në kushtetutë, nuk do të marrë fund "diktauti bullgar" ndaj popullit maqedonas.

Italia mbyll aeroportin kryesor të Sicilisë për shkak të zjarrit

KATANIA, 17 KORRIK - Aeroporti në qytetin sicilian të Katanias, një nga pikat kryesore turistike në Sicilinë lindore, është mbyllur deri të mërkurën për shkak të një zjarri, njoftoi kompania e menaxhimit të aeroportit në "Twitter". Zjari shpërtheu vonë të dielën dhe nuk pati të lënduar, njoftoi aeroporti. Zjarrfikësit thanë se ishin në gjendje të frenonin zjarrin rreth 90 minuta pasi u ndez, por nuk

dhanë detaje mbi shkakun e mundshëm apo ndonjë lidhje me temperaturat e larta aktuale në rajon. Catania është një nga qytetet italiane që lëshoi alarmin e kuq për temperaturat e larta të dielën, së bashku me kryeqytetin sicilian Palermo dhe qytetin e tretë më të madh në ishullin Mesina. Vendi po për gatitet për temperaturat të larta rekord në ditët në vijim.

Fluturimet në aeroportin sicilian, i cili, sipas grupit të sektorit Assoaeroporti, ishte i pesti më i ngarkuari në Itali vitin e kaluar, u pezulluan deri të mërkurën në orën 14:00 me kohën e Evropës Qendrore, njoftoi kompania. Agjencia e lajmeve Ansa njoftoi se pas shpërthimit të zjarrit, në pjesën e poshtme të ndërtesës u shfaq tym i dendur, duke bërë që njerëzit të largoheshin nga aeroporti në panik.



Osmani i inkurajon viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës të aplikojnë për njohje të statusit në komisionin shtetëror

SRPIA
24.15
Faton DËRMAKU

PRISHTINE, 17 KORRIK – Presidentja Vjosa Osmani priti në takim anëtarët e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës, të kryesuar nga kryetarja Leonora Selmani.

Në takim u diskutua për punën e komisionit, bashkëpunimin e vazhdueshëm me Presidencën e Republikës, si dhe rëndësinë e koordinimit të rregullt ndërinstucional në vazhdim të ndryshimeve të aprovuara në Kuvendin e Republikës në Ligjin, i cili, ndër të tjera, trajton statusin dhe të drejtat e personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-172.

Në këtë frymë, presidentja

Osmani vlerësoi zgjatjen e afatit për aplikim për dy vjet shtesë, por potencoi se është me rëndësi që kurdo që miratohen ndryshimet e ardhshme, afati i aplikimit të jetë i pakufizuar. Ajo shtoi se krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit e gjenocidi nuk janë krimet që mund të parashkruhen, prandaj edhe viktimat e këtyre krimeve të kryera nga regjimi i Millosheviqit duhet të kenë afat të pakufizuar për t'i parashtruar kërkesat për njohjen e statusit dhe të drejtave të tyre.

Më tutje, presidentja Osmani, duke u bazuar në Ligjin e sapomiraturat, përsëriti thirrjen e saj që të shfrytëzohet e drejta e garantuar me ligji për njohje të statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës.

Presidentja Osmani ka ritheksuar rëndësinë e ngritjes së vetëdijes për të drejtat e



viktimave të luftës të cilat ende ballafaqohen me stigmatizim dhe mungesë të drejtësisë, sikurse edhe rikonfirmoi rëndësinë e vazhdimi të trajtimit të kërkesave dhe

ankesave nga komisioni me profesionalizëm të lartë.

Në takim u diskutua edhe për bashkëpunimin me këtë komision në kuadër të edicionit të dytë të Forumit

Ndërkombëtar për Gratë, Pagen dhe Sigurinë, i cili do të mbahet në tetor, si dhe për bashkëpunimin në projekte e nisma të tjera të interesit të përbashkët.

Kosova formalizon kërkesën për anëtarësim në OGP, Krasniqi: Arritje jashtëzakonisht e rëndësishme



PRISHTINE, 17 KORRIK – Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka njoftuar se Kosova ka formalizuar kërkesën për anëtarësim në organizatën ndërkombëtare Open Government Partnership (OGP). Ministri Krasniqi thotë se sapo ka nënshkruar Letrën e Interesit, shkresë e cila formalizon kërkesën e

Republikës së Kosovës për anëtarësim në Open Government Partnership (OGP). "Ne si qeveri kemi synuar qeverisjen e hapur dhe transparente andaj j'është një hap ku Republika e Kosovës u bashkëngjitet vendeve me bashkëpunim të botë sa i përket angazhimit të saj konsistent për qeverisje të hapur, logjardhënie, me integritet,

inovacion, që rritë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe parandalon dhe lufton korrupsionin", ka shkruar në "Facebook" ministri Krasniqi. Sipas tij, anëtarësimi në Open Government Partnership është një "arritje jashtëzakonisht e rëndësishme sepse po bëhet vetëm pas 10 vjetësh pas përfundimit së parë për anëtarësim në këtë organizatë".

Ministria e Shëndetësisë bën thirrje për kujdes të shtuar ndaj vapës

PRISHTINE, 17 KORRIK – Ministria e Shëndetësisë në Kosovë u ka bërë thirrje qytetarëve të kenë kujdes nga temperaturat e larta të hënën dhe ditëve në vijim, për t'u shmangur komplikimeve të mundshme shëndetësore. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka bërë me dije se temperaturat të hënën në Kosovë mund të arrijnë deri në 36 gradë celsius.

Sipas Institutit, era me raste mund të ndikojë që temperaturat të arrijnë deri në 40 gradë celsius.

Mot i ngjashëm do të

mbizotërojë gjatë gjithë javës. Ministria e Shëndetësisë e ka përmendur rrezikun e goditjes nga vapa, andaj ka rekomanduar që njerëzit me sëmundje kronike të mos ekspozohen në reze të diellit në intervalin 10:00 - 17:00. Ky institucion ka porositur që në ditët me mot shumë të nxehtë qytetarët të qëndrojnë të hidratuar, të vishen me veshje të lehta, të pinë shumë ujë, të shmangin pijet me sheqer, t'i hapin dritaret, ta reduktojnë përdorimin e pajisjeve elektronike dhe të qëndrojnë të hije. "Nëse ju paraqiten

simptoma si kokëdhembje, mundim, marramendje, tharje e gojës dhe lëkurës, lajmërohuni tek institucioni më i afërt shëndetësor", është thënë në njoftim.

Agencia Evropiane e Statistikave, Eurostat, ka vlerësuar se mbi 61 000 persona kanë vdekur në Evropë gjatë valës së nxehtësisë vitin e kaluar. Me mot shumë të nxehtë janë duke u përballur Evropa, Shtetet e Bashkuara dhe vendet e Azisë. Temperatura mesatare globale e ka përkur një rekord të ri në javën e parë të korrikut.



Policia shpërndan broshura në pikat kufitare, të respektohen rregullat e trafikut

PRISHTINE, 17 KORRIK – Policia e Kosovës, duke pasqyruar rritjen e numrit të mjeteve të trafikut rrugor, sidomos gjatë sezonit veror,

ku ka organizime të ndryshme si dhe ardhja e bashkatdhetarëve, me qëllim të rritjes së sigurisë në trafik, ka filluar

shpërndarjen e brosurave në pikat kufitare dhe përmes njësjive policore të trafikut edhe për pjesëmarrësit e tjerë në trafik përmes të

cilave këshillojnë që të respektohen rregullat e trafikut sepse respektimi i këtyre rregullave ndikon në sigurinë e tyre.





Kurti për të dytën herë e refuzon Ramën

Për të dytën herë brenda pak ditësh kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka injoruar kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Herën e parë duke mos e pritur në Prishtinë, herën e dytë duke mos iu përgjigjur ftesës së tij për takim informal në mes të liderëve të Ballkanit në Tiranë. Për mospjesëmarrjen e kryeministrit Kurti, Rama tha: "Nuk shoh asnjë interes se ishin gjithë të ftuar, kush deshi erdhi, kush nuk mundi nuk erdhi". Opozita në Kosovë ka drejtuar kritika për Kurtin për mospjesëmarrjen në këtë takim, duke theksuar se ky është dezertim i politikës së jashtme të Kosovës

sa politik e më theks të ndërlidhja rajonale e me përfitime ekonomike.

Këto janë momentet e përfundimit të takimit në Tiranë për të cilin kryeministri Edi Rama tha se synoi pasjen e një produkti domethënës e hedhur një hap të mëtejshëm për ato që Procesi i Berlinit përfshin. "Prej ca kohësh ne jemi në një përjekje për të nxitur gjërave në hendekun që ekzistojnë mes vendeve anëtare dhe vendeve tona pas goditjeve të pandemisë, krizës energjetike të Ukrainës që kanë bërë që BE-ja ka shpërndarë fonde të konsiderueshme për vendet anëtare, gjë që e ka zgjeruar hendekun mes nesh dhe vendeve anëtare. Duke marrë parasysh këtë pasojë dhe të gjitha sfidat që sot janë të përbashkëta po aq janë të përvëqme ne jemi përjekur të krijimë një tjetër qasje, që paralelisht me procesin e negociatave të

kemi një mbështetje ekstra për vendet e Ballkanit Perëndimor", ka thënë Rama. Për mospjesëmarrjen e kryeministrit Kurti, Rama tha: "Nuk shoh asnjë interes se ishin gjithë të ftuar, kush deshi erdhi, kush nuk mundi nuk erdhi".

Pak përpara se në Tiranë të niste ky takim nga Prishtina, zyra e zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi u kujdes në të theksuarin e mospjesëmarrjes edhe të zëvendëskryeministrit, në mungesë të shefit të ndodhet në Greqi. Komisionari i Bashkimit Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliver Varhelyi, ka thënë të hënën se ka folur me kryeministrat e pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor për përkushtimin e BE-së drejt zbatimit të shpejtë të strategjisë për zhvillim të sektorit të ekonomisë në rajon.

Opozita në Kosovë ka

**EPOKA
E RE** | **Mal QORRAJ**

TIRANË, 17 KORRIK - Në Tiranë u mbledhën të hënën kryeministrat e vendeve të Ballkanit perëndimor për të folur për Procesin e Berlinit mbi planin e ri të mbështetjes financiare dhe ekonomike të BE-së për Ballkanin Perëndimor, ku mori pjesë edhe komisionari i Bashkimit Evropian për Zgjerimin dhe Fqinjësinë, Oliver Varhelyi, kryeministri i Malit të Zi, Dritan

Abazović, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski dhe kryeministrja e Serbisë, Ana Brnabić. Por në takimin e kërkuar nga Rama mungoi kryeministri Albin Kurti i cili zgjodhi të shkonte në ishullin turistik të Kretës në Greqi për takimin e një organizate politike të të majtëve. Samiti zyrtar i Procesit të Berlinit mbahet në tetor, në të cilin Albin Kurti konfirmoi se do të marrë pjesë. Mikpritësi kryeministri Edi

Rama mbërriti i pari në vilën qeveritare numër 30 për t'ua lënë vendin ardhjes të katër kryeministrave të tjerë. Përballë Oliver Varhelyi, komisionar për zgjerimin e BE-së, në drekën e punës kryeministri Edi Rama e ka vënë theksin në nevojën e pasjes së një qëndrimi të unifikuar të kërkesave për BE gjatë Samitit të Procesit të Berlinit në Tiranë pas dy muajsh. Kosova mungoi në këtë takim paqja informal, tejet i nevojshëm për këtë proces

“Bayraktarët” nuk do të mund të përdoren pa autorizimin e KFOR-it

PRASHINJE, 17 KORRIK - Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, thotë se pret nga institucionet e Kosovës që të koordinohen në lidhje me përdorimin e të gjitha kategorive të dronëve, përfshirë edhe ata “Bayraktar TB-2”.

Në një deklaratë me shkrim dërguar Radion Evropa e Lirë, KFOR-i kujton se komandanti i këtij misioni e ka autoritetin parësor mbi hapësirën ajrore të Kosovës, që nga përfundimi i luftës më 1999.

Një ditë më herët kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, njoftoi se vendi ka blerë dronë “Bayraktar TB-2” nga Turqia. Me blerjen e tyre, Kosova “është edhe më e sigurt”, tha ai dhe shtoi se oficerët e Forcës së Sigurisë së Kosovës janë trajnuar tashmë për përdorimin e dronëve.

Se sa dronë janë blerë, nuk është e qartë.

Por, kujton KFOR-i, hapësira e poshtme ajrore e Kosovës “mund të përdoret për nevoja specifike” dhe me “autorizim të mëparshëm nga komandanti i KFOR-it”.

Hapësira e poshtme ajrore nënkupton lartësinë deri në 6 250 metra.

Dronët “Bayraktar TB-2” fluturojnë kryesisht në lartësi deri në 5 000 metra.

Forca e Sigurisë e Kosovës është në proces të shndërrimit në ushtri.

Është e paraparë që deri në vitin 2028 ajo t’i arrijë të gjitha kapacitetet operacionale për, siç thuhet, “ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës, si dhe të qytetarëve, pronave dhe interesave të vendit”. Megjithatë, ajo nuk do t’i zëvendësojë forcat e KFOR-it që vazhdojnë të kenë rreth 4 000 trupë në Kosovë.

Zëvendëskryetari i komisionit parlamentar për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes në Kosovë, Enver Dugolli, thotë për Radion Evropa e Lirë se kur bëhet fjalë për çështje që bien edhe në domenin e misionit të KFOR-it, “ka bashkëpunim dhe



koordinim”. Bazuar në obligimet ligjore që ka Forca e Sigurisë e Kosovës, thotë ai, blerja e pajisjeve ushtarake është e domosdoshme...“pra, kjo çështje ka të bëjë me përgatitjen e Forcës së Sigurisë për të mbrojtur vendin, për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës”, thotë Dugolli, i cili vjen nga radhët e partisë në pushtet - Lëvizjes Vetëvendosje...“pra, ish-ministri i Mbrojtjes së Kosovës, Anton Quni, anëtar i komisionit për çështje të sigurisë në NATO-s dhe KFOR-it në Kosovë. Nuk është diçka që nuk mund të tejkalohet nëse ekziston një bashkëpunim dhe një koordinim i mirë me autoritetet e NATO-s dhe me partnerët tanë”, thotë Quni.

Autoritetet e Kosovës nuk kanë treguar çmimin e dronëve të blerë, por në treg ata njihen si të lirë dhe efektive. Mentor Vajali, drejtor ekzekutiv i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, vlerëson se nëse shikohen kostot e pajisjeve

radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës - parti në opozitë. Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ai shton se Qeverinë e Kosovës e presin sfida për të siguruar kompetenca ligjore dhe Forcën e Sigurisë në lidhje me aktivitetet e saj në hapësirën ajrore të vendit. “Kjo është çështje e cila duhet të jetë në fokusin e qeverisë në të ardhmen. Do të thotë, ta sigurojë infrastrukturën ligjore, pasi që disa kompetenca mbi kontrollin ajror janë çështje ekskluzive të NATO-s dhe KFOR-it në Kosovë. Nuk është diçka që nuk mund të tejkalohet nëse ekziston një bashkëpunim dhe një koordinim i mirë me autoritetet e NATO-s dhe me partnerët tanë”, thotë Quni.

Autoritetet e Kosovës nuk kanë treguar çmimin e dronëve të blerë, por në treg ata njihen si të lirë dhe efektive. Mentor Vajali, drejtor ekzekutiv i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, vlerëson se nëse shikohen kostot e pajisjeve

lufatare, të cilat sigurohen nga ushtritë e botës, fillimisht duken të pajustifikueshme në rast se ato nuk përdoren. Nga ky këndvështrim mund të shihen edhe dronët Bayraktar të blerë nga Kosova, thotë ai.

Por, shton Vajali, pajisjet lufatare jo gjithmonë blihen për t’u përdorur me çdo kusht. “Sektori i mbrojtjes bëhet për t’u siguruar se në çfarëdo rrethane hipotetike që mund të shfaqet, përgatitjet e mbrojtjes të jenë në nivel të duhur. Në këtë këndvështrim kjo përfornim që është bërë nga ushtria e Kosovës nuk paraqet ndonjë problem të madh. Mbaje jo domosdo në presim që dikush do të na sulmojë. Por, nëse na sulmon, atëherë ne duhet të jemi të përgatitur”, thotë Vajali për Radion Evropa e Lirë. Droni “Bayraktar TB-2” është fluturake pa pilot, që kontrollonet nga distanca. Ky dron është zhvilluar në Turqi nga Selcuk Bayraktar, i diplomuar në Institutin e

Teknologjisë në Massachusetts. “Bayraktar TB-2” mund të dënojë në qiell deri në 27 orë dhe fluturimi mundësohet nga një motor i thjeshtë me helikë. Ky dron mund të fluturojë deri në 150 kilometra nga baza e tij. Ai është vlerësuar mjaft i rëndësishëm në konfliktet në botë, përfshirë edhe atë në Ukrainë.

“Bayraktar TB-2” aktualisht përdoret nga së paku 11 ushritë të botës.

Autoritetet e Kosovës nuk kanë bërë me dije se kur kanë aritur dronët në Kosovë, por jozyrtarisht është thënë se kjo ka ndodhur në muajin maj, pak para stërvitjeve ushtarake “Defender Europe 2023”.

Kosova është përjashtuar nga këto stërvitje, të udhëhequra nga SHBA-ja, për shkak të situatës së tensionuar në verium e saj të banuar me shumicë serbe. Tash e gati dy muaj qytetarë serbë atje janë duke kundërshtuar vendosjen në zyrat komunale të kryetarëve shqiptarë.

drejtuar kritika për Kurtin për mospjesëmarrjen në këtë takim, duke theksuar se ky është dezertim i politikës së jashtme të Kosovës. Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ka reaguar për mospjesëmarrjen e kryeministrit Albin Kurti në takimin përgatitor të Tiranës për Procesin e Berlinit, ku ishte i ftuar nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Ai ka theksuar se mospjesëmarrja e kryeministrit Kurti në takim përgatitor të Tiranës për Procesin e Berlinit është dezertim i politikës së jashtme të Kosovës. “Kjo

ndodh për shkak të inatit të papeshuar dhe një sërë pretekstesh të ndërthurura keq që tregojnë se Kosova ka mbetur pa zë në Ballkan, në Evropë dhe botë”, ka shkruar Hoxhaj në “Facebook”.

Kryetari i AKR-së, deputeti Behgjet Pacolli, ka thënë se mospjesëmarrja e Kosovës në takimin përgatitor të Samitit të Berlinit në Tiranë e “gëzon shumë Serbinë”. “Mospjesëmarrja e Kosovës në takimin përgatitor të Samitit të Berlinit, pa marrë parasysh fajin e kujt është, që tani kryesohet nga

Shqipëria, është lajmi më i keq që mund t’i ndodhë Kosovës. Kjo iniciativë ka në fokus integrimin sa më të shpejtë të rajonit në BE dhe se aty janë bërë shumë lehtësime për Kosovën duke pasur parasysh se Serbia gjithmonë ka qenë refuzuese ndaj pjesëmarrjes së Kosovës. Mospjesëmarrja e Kosovës e gëzon shumë Serbinë. Keqardhja ime është mungesa totale e përgjegjësisë së qeverisë dhe kryeministrit që, për kundërshtim të ftuar, refuzoi pa asnjë arsye”, ka shkruar Pacolli në “Facebook”.

Procesi i Berlinit

Procesi i Berlinit u vendos në vitin 2014 me iniciativën e ish-kancelares gjermane Angela Merkel, me qëllim të lidhjes dhe integritimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor përpara se të anëtarësohen në Bashkimin Evropian.

Procesi i Berlinit shërben si një platformë për bashkëpunimin e nivelit të lartë ndërmjet përfaqësuesve zyrtarë të nivelit të lartë të së ashtuquajturës Gjashtëshesë e Ballkanit Perëndimor, e cila përbëhet nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Procesi përfshin edhe institucionet e BE-së, institucionet financiare ndërkombëtare dhe shoqërinë civile në rajon.

Samiti i nëntorit në Berlin përfaqëson, gjithashtu, ringjalljen e procesit, që kur kancelari Olaf Scholz drejton qeverinë në Berlin. Sipas njoftimit, samiti i ardhshëm do të organizohet në kryeqytetin shqiptar, Tiranë.

Nënskruhet marrëveshja për projektin "Ndërtimi i urave përmes artit dhe kulturës..."

PRISHTINË, 17 KORRIK - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparrin Rama, së bashku me ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier dhe Leutrim Fishëkju, bashkëthemelues dhe drejtor i OJQ "Autostrada Biennale", nënshkruan marrëveshjen e

bashkëpunimit për projektin "Ndërtimi i urave përmes artit dhe kulturës" programi i shkëmbimit kreativ ShBA - Kosovë. Qëllimet bazë të kësaj marrëveshje bashkëpunimi janë të promovojë dhe të mbështesë industrinë kreative dhe kulturore në Kosovë, të

mundësojë shkëmbimin e njohurive dhe shkaktëvese ndërmjet artistëve vendas dhe ekspertëve amerikanë si dhe të rritë mirëkuptimin ndërkultoror përmes iniciativave të diplomacisë kulturore", ka thënë kryetari Rama.



Kryetari i Gjilanit paraqet para qytetarëve raportin gjashtëmujor të punës

GJILAN, 17 KORRIK - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka paraqitur para qytetarëve raportin gjashtëmujor të punës për vitin 2023. Ai ka theksuar se një një e madhe është bërë edhe në sektorin e arsimit, duke përfunduar renovimin e shkollave hierjes së inventarit, laboratorëve e investimet në eficientë të energjisë në shkollat "Rexhep Elmazi", "Mehmet Isai", "Abdullah Tahiri", "Musa Zajmi", "Marin Barleti", "Nazmi Hoxha" e "Abaz Ajeti". "Në këtë periudhë është përfunduar çelësi në Zhegër, ndërkaq çerdhja në lagjen Arbëria është në përfundim e sipër dhe kap vlerën e mbi 800 mijë euro, derisa jemi duke e ndërtuar edhe çerden tjetër në lagjen Qarku 1, e cila kap shifrën e afro 700 mijë euro. Në përfundim e sipër është edhe çerdhja në fshatin Dobërçan. Jemi duke e bërë një analizë edhe për mundësinë e ndërtimit të dy çerdheve tjera modulare, në zonat rurale", është shprehur Hyseni. Ai ka theksuar punën në projektin e rëndësishëm të ndërtimit të parkut "Banja", i cili ka 2 hektarë hapësirë dhe po bëhet në vlerë prej 250 mijë eurosh, derisa ka nënvizuar edhe investimet e tjera në ndërtim të



rugëve, kanalizimeve dhe ndricimit publik. "Nga 11 milionë euro borxhe të trashëguara vetëm për shpronësim dhe 12 milionë në total për borxhet reale, për një vit e gjysmë kanë mbetur vetëm edhe 3 milionë e 787 mijë euro borxhe për t'u paguar. Në vitin e ardhshëm do ta mbyllim gjithë obligimin financiar të trashëguar", ka deklaruar Hyseni. Ndërkohë, janë 18 projekte që

parashihen si investime kapitale, ku të ndara janë rreth 7 milionë euro si bashkëfinancim me institucionet e tjera. Dy projektet më të mëdha që presin të realizohen janë Kult Qendra në lagjen Dardania dhe rruga "Hamdi Kurtishi". Është duke vazhduar ndërtimi i kanalizimit në Livoc të Epërm, Livoc i Ulët, Kodra e Thatë dhe Lagja VIII, ku 15 mijë banorë do të kycen në rrjet. "Me kërkesë të qeverisë kemi


Ai ka nënvizuar përkrahjen nëpërmjet start-upëve që ua ka bërë të rinjë dhe grave në biznes e ndërmarrës, ndërkaq pohoi se buxheti për subvencionimin e sportit, kulturës dhe rinisë për vitin 2023 është rreth 200 mijë euro apo 43 për qind më shumë krahasuar me vitin paraqark. Për më tepër, kryetari Hyseni ka bërë me dije se komuna tashmë ka aprovuar edhe planin e banimit 2023-2025, të cilin e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm për planifikim afatgjatë, qoftë për planifikim social apo forma të tjera. "55 familje me gjendje të rëndë është numri total të cilat ua kemi subvencionuar qiratë, 23 prej të cilave janë nëna vetushqyese", u shpreh ai, derisa theksoi se kanë përmbyshur edhe zotimin për ndarjen e shumës 100 euro për lehonat. "Për këtë vit kemi ndarë edhe si formë të subvencionimit të pagave në vlerë prej 300 euro në 12 muaj për punësim të 20 personave me aftësi të kufizuara, ndërsa edhe për pesë personat e tjerë të cilët kanë aplikuar do të bëjmë përpjekje të ofrojmë përkrahje", tha kreu i komunës. Përveç të tjerash, kryetari Hyseni ka bërë me dije se këtë vit buxheti për subvencionimin e fermerëve është rritur për 88 për qind në vlerë prej 880 mijë eurove.

Arbër Zenuni zgjedhet kryesues i Kuvendit Komunal të Rahovecit

RAHOVEC, 17 KORRIK - Kuvendi Komunal i Rahovecit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur sot ka zgjedhur kryesuesin e Kuvendit në raundin e parë me 17 vota "për". Shtet i grupit të AAK-së, Hasan Përboq, në emër të të kuvendarëve nënshkrues që thirrën këtë seancë, propozoi

për kryesues anëtarin e kuvendit, Arbër Zenuni. Ky i fundit nuk kishte kundërkandidat nga partitë e tjera pjesëmarrëse në Kuvend. Nga 18 anëtarë të pranishëm të Kuvendit, të gjithë morën pjesë në votim. Gjatë numërimit të votave nga komisioni verifikues, doli që

17 vota të jenë "për" dhe një votë të jetë e pavlefshme. Kryesuesi i sapozgjedhur, Arbër Zenuni, në fjalën e tij falënderoi të gjithë kuvendarët për votim dhe besim. Në fund, premtoi punë konstruktive dhe tha që pret bashkëpunim të sinqertë nga të gjithë.



Ferizaj, shpejtëtarët përfitojnë makina për vulosjen e vezëve

FERIZAJ, 17 KORRIK - Komuna e Ferizajt u ka ndarë shpejtëtarëve të kësaj komune makina për vulosjen e vezëve. Kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, është shprehur se ky investim do të ndihmojë në garantimin e

sigurisë ushqimore. "Në kuadër të mbështetjes së shumanshme të bujqve dhe fermerëve ferizajas nga Drejtoria e Bujqësisë, ndamë makinat për vulosjen e vezëve, duke investuar mbi të gjitha në një segment

të rëndësishëm të sigurisë ushqimore, po ashtu duke përfshirë shpejtëtarët në skemën tonë mbështetëse në këtë degë të rëndësishme të shëndetit dhe ekonomisë", ka shkruar Aliu në "Facebook".

Mehmeti kërkon nga Presidenca që të mos dekretohet guvernatori i ri i BQK-së



Prishtinë, 17 korrik - Deputetët e Kuvendit të Kosovës me 56 vota e kanë zgjedhur Ahmet Ismailin guvernator të ri të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), derisa kundërkandidati i tij, Luzdim Ismajli, ka marrë vetëm katër vota.

Mirëpo, sipas ish-guvernatorit të BQK-së, Fehmi Mehmeti, procesi i rekrutimit për këtë pozitë ka pasur parregullsi. Mehmeti për "Telegrafi"-n ka konfirmuar se i ka dërguar letër presidentes Vjosa Osmani, nga e cila ka kërkuar që të mos e dekretojë guvernatorin Ismaili. "Marrë parasysh deytat dhe përgjegjësitë e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, pasi që duhet ta udhëheqë nërin nga dikasteret më të rëndësishme të vendit, luteni shumë që para ndërmarjes së hapave për dekretimin e personit të propozuar të kërkoni sqarime për mënyrën e përzgjedhjes së tij dhe shkeljet që janë bërë

gjatë fazave paraprake dhe të ndaloni këto parregullsi, pasi që e them me bindje të plotë që përveç shkeljeve ligjore dhe mosrespektimit të rregullorevë për rekrutim, është bërë edhe shkelje e Kushtetutës së Republikës së Kosovës e që është akti më i lartë juridik i shtetit", thuhet në letërën e Mehmetit.

Ai shton se shkeljet kanë ndodhur duke filluar nga Bordi i BQK-së, pabarazia dhe mosndërmarrja e hapave të duhura nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transferime me rastin e evidentimit të shkeljeve.

Në bazë të Ligjit për Bankën Qendrore të Kosovës, guvernatori si kryeshef ekzekutiv i këtij institucioni është pjesë e Bordit dhe kryesues i Bordit Ekzekutiv. Sipas procedurave, emri i guvernatorit të BQK-së do të shkojë për dekretim të presidentia Osmani.

Pse është e rëndësishme marrëveshja për eksportin e drithërave përmes Detit të Zi?

Korrik, 17 korrik - Një marrëveshje që e lejon Ukrainën të eksportojë drithëra përmes Detit të Zi do të skadojë në fund të ditës së hënë, më 17 korrik, pasi Rusia tha se do ta pezullojë pjesëmarrjen e vet në të.

Ujdia, e ndërmjetësuar nga Kombet e Bashkuara dhe Turqia në korrik të vitit të kaluar, kishte për qëllim ta zbutte krizën globale të ushqimit duke i lejuar drithërat ukrainase, të bllokua nga konflikti Rusi - Ukrainë, të eksportoheshin në mënyrë të sigurt.

Ukraina është prodhuese e madhe e grurit dhe farave vajore dhe ndërprerja e eksportimit të tyre kur shpërtheu lufta nxiti rritjen rekorde të çmimeve të produkteve ushqimore në gjithë botën.

Marrëveshja, që u arrit në korrik 2022, gati pesë muaj pas fillimit të luftës, ndihmoi në uljen e çmimeve dhe zbutjen e krizës globale ushqimore.

Gruri ukrainas, po ashtu, ka

luajtur rol të drejtpërdrejtë, me 725 200 tonë, apo 2.2 për qind të furnizimeve të dërguara përmes korridorit të përdorur nga Programi Botëror i Ushqimit i Kombeve të Bashkuara (PBUKB) për ndihmat për vendet si Etiopinë, Somalinë dhe Jemenin.

Çmimet e grurit dhe farave vajore janë rritur tashmë si pasojë e lajmeve se Rusia do ta pezullojë pjesëmarrjen e vet në këtë marrëveshje. Kjo rritje do të bëjë që çmimet do të rriten edhe më shumë për produktet bazë si buka dhe pastat në muajt në vijim.

Gjendja, megjithatë, është më e mirë tani se në muajt pas fillimit të luftës, sepse furnizimet me grurë nga prodhuesit e tjerë si Brazili janë rritur.

Çmimet e grurit, ingredientit kryesor në bukë, kanë rënë për rreth 14 për qind deri tani këtë vit, ndërsa të misrit ka rënë për rreth 23 për qind.

Kriza e tanishme globale



ushqimore nuk e ka ndër mend të marrë fund. Programi Botëror i Ushqimit (PBU) tha muajin e kaluar se emergjencat e shumta

kanë krijuar krizën më të madhe dhe më të koklevitur humanitare të urisë në 70 vjetët e fundit.

Në vitin 2022 një numër rekord

prej 349 milionë njerëzve përjetuan uri akute dhe 772 mijë të tjerë ishin buzë urisë, tha PBU-ja në një raport vjetor.

Ministri Peci: Instituti Bujqësor për më shumë se një dekadë ka tjetërsuar toka, prona dhe banesa


Prishtinë, 17 korrik - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë e Zvillimit Rural, Faton Peci, me anë të një reagimi publik, ka thënë se Instituti Bujqësor i Kosovës për më shumë se një dekadë ka tjetërsuar toka, banesa dhe prona. Sipas Peci, në mungesë të veprimit të institucioneve të drejtësisë, këto veprime janë

bërë për interesa personale. "Në mungesë të veprimit të institucioneve të drejtësisë do të filloj të ndaj me qytetarët dëshmi se si aktorë të ndryshëm në institucione kanë bërë tjetërsimin e pronave shtetërore për interesa meskinë dhe personale", thuhet në reagimin e Peci.

Ai shton se brenda kësaj periudhe janë tjetërsuar rreth 100 hektarë toka. "Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK) për më shumë se një dekadë ka tjetërsuar rreth 100 hektarë me toka dhe ka tjetërsuar prona/banesa të IBK-së me "vërtetime", ka shkruar Peci në "Facebook".



Vala e të nxehtit në Evropë: A është e sigurt të udhëtosh dhe çfarë duhet pasur parasysh nëse bën një gjë të tillë?



Vendet në të gjithë Mesdheun janë në kontrollin e një vale rekord të të nxehtit pasi janë goditur nga 'stuhia e dytë e të nxehtit' brenda një jave. Pjesa më e madhe e Evropës Jugore, duke përfshirë vendet e pushimeve si Spanja, Italia, Kroacia dhe Greqia, ka parë temperatura jashtëzakonisht të larta që pritet të zgjasin për të paktën një javë tjetër, shkruan Euronews, përcjell Telegafi.

Disa pjesë të Italisë jugore dhe Greqisë presin temperatura maksimale mbi 40 gradë Celsius pasi moti vazhdon të bëhet më i nxehtë.

Madje, parashikuesit kanë paralajmëruar se rekord evropian i temperaturës prej 48.8 C – i regjistruar afër Siracusa në Sicili në vitin 2021 – mund të thyhet.

Pra, çfarë do të thotë kjo për pushuesit që shkojnë në Evropën Jugore këtë verë?

A është e sigurt të udhëtosh gjatë valës së të nxehtit?

Një gjë është e sigurt – nëse udhëtoni në një vend të prekur nga kjo valë, vala e të nxehtit do të jetë shumë e nxehtë.

Në Itali, 16 qytete – shumica e tyre në rajonet qendrore dhe jugore – janë tani në këshilla të ngrohjes për shkak të një niveli të lartë rreziku për të mosuhatit, të rinjtë dhe njerëzit e tjerë të ndjeshëm.

Rreziqet kryesore janë dehidrimi dhe mbinxehja, të cilat janë një kërcënim më i

madh për njerëzit në këto grupe njerëzish të ndjeshëm. Por alarmet e kuqe nënkuptojnë se të gjithë mund të jenë në rrezik nga të nxehtit, me autoritetet që këshillojnë njerëzit të shmangin rrezet e diellit direkte midis orës 11 dhe 18.

Qytetet e prekura përfshijnë destinacione të njohura si Bologna, Firenze dhe Roma.

Dhe nëse vendosni të udhëtoni, turistëve u kërkohet të sigurohen që të aplikojnë krem kundër diellit, të shmangin qëndrimin jashtë gjatë pjesëve më të nxehta të ditës dhe të qëndrojnë të hidratuar.

Gjithashtu, njerëzve u kërkohet të mos pinë alkool pasi mund të rrisë mundësinë e dehidrimi, lodhjes nga nxehtësia ose goditjes nga nxehtësia.

Veç këtyre, çështjet shëndetësore nga të nxehtit kanë bërë një tendencë në institucionet mjekësore lokale në shumë rajone.

A duhet të anulohet pushimet për shkak të valës së të nxehtit?

Disa udhëtarë madje kanë zgjedhur të anulohen pushimet e tyre ose kanë ndërruar rezervimet e tyre me një vend që nuk është aq i nxehtë – sidomos ata me kushte shëndetësore apo faktorë të tjerë që i bëjnë të prekshëm ndaj të nxehtit.

Por fluturimet dhe paketat e

pushimeve janë ende duke vazhduar normalisht pavarësisht vapës.

Kjo do të thotë që zbatohet politikat standarde të anulimit dhe mund të paguani një tarifë nëse vendosni të mos shkoni në udhëtim.

Për shumë rezervime, kjo mund të jetë deri në 90-100 për qind të kostos nëse anuloni minutën e fundit.

Kur do të përfundojë vala e të nxehtit në Evropë?

Javën e kaluar, Evropa Jugore u godit nga një anticiklon i quajtur Cerberus.

Kjo zonë me presion të lartë filloi në Sahara përpara se të lëvizte nëpër Afrikën veriore dhe në Mesdhe.

Të dielën (16 korrik), një anticiklon i quajtur 'Charon', filloi të lëvizte nëpër Evropë, duke intensifikuar më tej problemet e motit të kontinentit.

Sinoptikanët thonë se periudha e motit jashtëzakonisht të nxehtë pritet të zgjasë deri në fund të korrikut.

Por, temperaturat e larta mund të 'lehtësohen' në vendet e Evropës Perëndimore si Spanja dhe Portugalia gjatë ditëve të ardhshme.

A do të hapen atraksionet turistike gjatë valës së të nxehtit?

Disa atraksione të njohura u

është dashur të mbyllën për shkak të vapës me raportime për turistët që rrezohen në destinacione të mbushura me njerëz, përcjell Telegafi.

Kështu, autoriteteve greke u desh të mbyllnin përkoheisist Akropolisin në Athinë të premten gjatë pjesës më të nxehtë të ditës.

Ata e mbyllën përsëri edhe më herët gjatë ditës gjatë pjesës tjetër të fundjavës pasi temperatura u rritën.

Raportohet gjithashtu se autoritetet italiane po shqyrtojnë vendosjen e kufizimeve për qasjen në monumentet historike gjatë pjesës më të nxehtë të ditës.

Në Athinë dhe disa qytete të tjera greke, orari i punës është ndryshuar edhe për sektorin publik dhe shumë biznese për të shmangur vapën.

Qeveria ka urdhëruar ndërprerjen e punës nga ora 12:00 deri në 17:00 në zonat ku vapa është shumë e lartë.

Disa pjesë të Romës kanë pësuar gjithashtu ndërprerje të energjisë pasi rrjetet e energjisë elektrike janë të tensionuara nga ngarkesa e shaktuar nga kondicionerët.

Veç këtyre, fluturimet janë pezulluar në aeroportin e Katanias në ishullin jugor italian të Sicilisë pas një zjarri të madh. Megjithatë, nuk ka të dhëna nëse ka lidhje me temperatura e larta.

Ajtë të dielën në mbërmje (16 korrik) u thirrën zarrfikësit për të shuar zjarrin dhe aeroporti u evakuua.

Tashmë ai është shuar dhe nuk

ka persona të lënduar nga incidenti.

Aeroporti ka njoftuar se fluturimet janë pezulluar deri të mërkurën më 19 korrik në orën 14:00.

Vala e të nxehtit shkakton zjarre në La Palma, Spanjë

Në ishullin La Palma në Kanarinat e Spanjës, një zjarr shpërthie mes temperaturave të larta të shtunën (15 korrik). Mijëra njerëz u evakuuan pasi erërat e forta dhe toka e thatë i bëhë zyrtarët të shqetësuar për përhapjen e mundshme të zjarrit.

Moti tani ka ndryshuar dhe përhapja e zjarrit është ngadalësuar duke lejuar njerëzit të kthehen në shtëpitë e tyre, por kushtet nënkuptojnë një shans të shtuar për zjarret në Evropën Jugore.

Edhe Kroacia ka parë zjarre në Spanjë kanë paralajmëruar në pjesën më të madhe të vendit. Autoritetet në Greqi kanë thënë gjithashtu se erërat e forta të kombinuara me kushtet e nxehta dhe të thata po arrijnë rrezikun e zjarreve.

Ndaj, nëse po udhëtoni diku me një rrezik të shtuar të shpërthimit të flakëve, sigurohuni që të ndiqni udhëzimet dhe rregullat lokale për të shmangur ndezjen aksidentale të një zjarri.

/Telegafi

Bruce Lee dhe miti që jehon edhe 50 vjet pas vdekjes së tij



Nga: Steve Rose /
The GUARDIAN
Përkthimi:
Telegrafi.com

Triumfi në çmimet Oscar i filmit *Everything, Everywhere All At Once*, në fillim të këtij viti, është përkujtim, 50 vjet pas vdekjes, se çfarë shtegu ka hapur Bruce Lee. Lee e hapi derën e përfaqësimit aziatik pothuajse i vetëm, edhe pse vdiq shumë shpejt për të qenë përfytyrues i asaj fame.

Lee është nga vjet e rralla që është më i madh se filmat e vet. Pavarësisht se la një pjesë të vogël të punës – vetëm katër filma të plotë – praktikisht e krijoi një zhanër të tërë dhe e shkroi librin për aksonin e Hollivudit. Lee e përshkon ADN-në e kulturës globale: videolojërë, hip-hop dhe arte të përziera marcialë, për të mos përmendur ngritjen e përgjithshme të idealit fizik maskullor, me zero dhjam në trup. Fakti që vdiq i ri, në rrethana çuditërisht banale (nga reagimi ndaj një ilaçi kundër dhimbjeve) vetëm sa e shton mitin për të.

Lee ndërtoi gjithashtu një personazh unik – intensiv, të disiplinuar, fizik por edhe cerebral – vite dritë larg stereotipave perëndimore të

maskulinitetit aziatik, kur ai u fut për herë të parë në lojë në Hollivudin e mesit të viteve 1960. Lindi në San Francisco, më pas u rrit në Hong-Kong, përpara se të kthehej në ShBA në moshën 18-vjeçare. Ishte një kohë kur burrat aziatikë lindorë përshkruheshin si shërbëtorë, zuzar të këqij ose bufonë me dhembë (shpesh të luajtur nga aktorët e bardhë, si aktori Mickey Rooney në filmin *Breakfast at Tiffany's*). Lee u zemërua kur u përdorur si ndihmës i nënshtruar në serialin televiziv *The Green Hornet*. Pavarësisht se në artet marcialë ka trajnuar një listë të aktorëve të famshëm (përfshirë emrat Steve McQueen, James Coburn dhe Sharon Tate), Lee kuptoi se ShBA-ja nuk ishte gati të pranojë një lider aziatik.

Fyerja e fundit erdhi me serialin televiziv të viteve 1970, *Kung Fu*. Është e kontestuar përshirja e tij në zhvillimin e serisë që ndoqi një murg Shaolin në Perëndimin e Vjetër. Sido që të jetë, kaloi në audicion për rolin kryesor, për t'u mundur nga David Carradine i cili nuk kishte as prejardhje kineze dhe as njohuri për artet marcialë.

Pas kthimit në Hong-Kong në vitin 1971, Lee krijoi katër

filma në dy vjet dhe shpërtheu si yll global. Përveç shfaqjes së afësive të tij fizike, filmat e tij ishin tregime të rezistencës. Qëndroi pranë punëtorëve të shtypur të fabrikës dhe kundër korrupsionit kriminal në *The Big Boss*; në *Fist of Fury* e nisi një kryqëzatë kundër shtypjes koloniale në Shanganin e viteve 1920 (dhe, si rrjedhojë, në Hong-Kongun e viteve 1970 të sunduar nga Britania), duke i detyruar kundërshtarët japonezë të hanë fjalët e veta kur e përshkruan Kinën si "Njeriu i sëmurrë i Azisë Lindore". Te *The Way of the Dragon* e shpëton restorantin e familjes dhe ai ballafaqohet me Chuck Norrisin në Koloseum. Nuk kishin vetëm audienca vendase; Lee u bë simbol universal i sfidës: një burrë me një rrëzë që kërkonte të shprehej me mjetet që kishte në dispozicion. Kur studentët e Hong-Kongut rezistojnë autoritarizmit kinez më 2019, e adoptuan maksimën e tij: "Bëhu ujë".

Suksesi i këtyre filmave e tërhoqi më në fund vëmendjen e Hollivudit, por, edhe me klasikun e tij *Enter The Dragon* (që u shfaq një muaj pas vdekjes së tij), atij nuk i besua ta mbante një film si i vetëm, kështu që u shoqërua nga Jim Kelly dhe

John Saxon. Mania e kung-fusë e viteve 1970 përfshiu gjithçka, nga stripat (Stan Lee i *Marvel-it* dikur e përshkroi si "superhero pa kostum") deri te muzika pop. Në atë kohë, Lee kishte rigjallëruar edhe industrinë e filmit në Hong-Kong, që ka dërguar një fluk të aktorëve drejt Perëndimit: Jackie Chan, Jet Li, Donnie Yen, Maggie Cheung dhe, natyrisht, Michelle Yeoh. Për të mos përmendur një rrymë të aktorëve të arte marcialë, nga Jean-Claude Van Damme te Jason Statham.

Po aq i rëndësishëm ishte eksporti i krijuesve të filmave aksion, si John Woo dhe Yuen Wo Ping – ky i fundit ia dha ngjyrimin e veçantë filmave Matrix. Në shekullin XXI, aksioni me shije të Hong-Kongut u bë përbërës i domosdoshëm i aksionit dhe i tillë ka mbetur që atëherë. Mund të vizatoni një linjë të drejtëpërdrejtë nga Lee te, le të themi, Mission: Impossible me aktorin Tom Cruise (Woo bëri regjinë e pjesës së dytë), Shang-Chi të *Marvel-it* (stripi fillimisht u frymëzua nga Lee) ose te John Wick me Keanu Reevesin (ylli dhe regjisori i të cilit, Chad Stahelski, punuan në *The Matrix*). Dhe, të mos e harrojmë Quentin Tarantinon që huazoi me shumicë nga kinemaja e

Hong-Kongut (*Reservoir Dogs* ndërlidhet me narrativën e Ringo Lamit te *City on Fire*) dhe në Kill Bill, Uma Thurman vesh tuta të verdha të stilit Bruce Lee, duke u përballur me ... David Carradinen. Tarantino bëri pak për t'ia kthyer nderin në *Once Upon a Time in Hollywood*, ku Lee përshkruhej (i luajtur nga Mike Moh) si "burrë i vogël me një gojë të madhe" – sipas fjalëve të Brad Pittit i cili pothuajse e rrahu në një përleshje. U konsiderua si një karikaturë fyese nga shumë njerëz, përfshirë vajzën e Leesë, Shannon. "Nuk kishin nevojë ta trajtonin atë në mënyrën se si e trajtonte Hollivudi i bardhë kur ai ishte gjallë", tha ajo.

Problemet nuk janë zhdukur plotësisht, sa i përket "zbardhjes" së përmbajtjes aziatike, stereotipizimit dhe nënperfaqësimit. Por, ka pasur përparim, dhe Lee duhet të falënderohet. Përtej kësaj, është ende emocionues (për ta parë në ekran. Shumë prej filmave të tij tani duken të tejkaluar, por fiziku dhe prania janë ende mahitëse. Ai ishte njeri i përsosur, i krijuar nga vetja, por edhe njeri i popullit. Nuk është çudi që ai ende jehon. /Telegrafi/

EURO GLASS
 SEKURITË PËRKRAHËS
 ZËRYEFT
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@five.com

SPORT



Ndaj Zvicrës synohet fitorja, kërkohet përkrahje e tifozëve



"Epoka e re"

PRISHTINË, 17 KORRIK - Kosova do të përballë me Zvicrën në njërin nga ndeshjet më të rëndësishme në vitet e fundit në basketboll. "Dardanët" përballen me Natin në kuadër të Rrethit të Tretë Parakualifikues për "Eurobasket 2025". Në konferencën për media të organizuara nga Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) është folur për rëndësinë e kësaj përballje dhe përkrahjen nga tifozët, si dhe organizimin e kësaj ngjarje. Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, ka folur për rrjedhën e përgatitjeve. "Të gjitha përgatitjet rreth kësaj ndeshje janë bërë me kohë, ndërsa biletat do të dalin në shitje nga dita e sotme deri të mërkurën. Një ditë do të shiten në Prishtinë, ndërsa për tre ditë në Prizren. Çmimi është 3 Euro. Kjo ndeshje është shumë e rëndësishme për ne, andaj kërkojmë përkrahjen nga publiku. Gjithashtu këtu ndeshje e madhështon më shumë me prezencën e tij Drejtori Ekzekutiv i

FIBA Evropës, Kamil Novak. Në fund, por jo nga rëndësia kërkohet përkrahje edhe për djemtë e Kosovës U16, ku po ashtu më 19 korrik fillon Kampionati Evropian, Divizioni C, ndërsa do të vazhdojë deri më 27 korrik në palestrenë "1 Tetori" në Prishtinë", është shprehur Dushku. Lidhur me përgatitjet e Përfaqësueses A, ka folur Menaxheri i Përfaqësuesve të Kosovës, Adriatik Rraci. "Përgatitjet mund të them se kanë shkruar shumë mirë. Kemi filluar nga 1 korriku dhe më 9 korrik kemi zhvendosur në Prizren, aty ku do të zhvillohet përballja me Zvicrën. Të shtunën kemi zhvilluar një miqësore me Sheppërinë për tu përgatitur sa më mirë dhe shpresojmë në rezultate pozitive", ka deklaruar Rraci. Përzgjedhësi i Kosovës, Rami Hadar, është shprehur optimist para sfidës ndaj Zvicrës. "Mund të them se jam i kënaqur me angazhimin e basketbollistëve në stërvitje dhe kushteve të ofruar nga Federata e Basketbollit e Kosovës. Kemi analizuar sa kemi mund Zvicrën, ku njihim lojtarët dhe trajnerin. Do të

japim më të mirën për rezultat pozitiv", nënvizoi Hadar. Kapitëni i Kosovës, Dardan Berisha ka kërkuar përkrahjen nga "Dardanët". "Nuk ka qenë lehtë, pasi ka qenë 2 muaj pushim, por besoj se jemi gati dhe do të japim maksimumin. Të mërkuar është ndeshja e parë dhe tepër me rëndësi më ne. Përkrahja nga tifozët është shumë e rëndësishme për ne. Kushetë kanë qenë të mira nga ana e FBK-së dhe me punën e trajnerit që ka bërë, jemi gati. Besoj që palestina do të jetë e mbushur dhe do të kemi përkrahjen e tyre. Ne do të japim 100 % nga vetja jonë. Mendoj se jemi më të fortë se herët e kaluara, pasi Lisi (Shoshi) dhe Dardani (Kapiti) janë rikthyer në kombëtare. E rëndësishme për ne është të luajmë lojën tonë", deklaroi Berisha. Kosova për herë të parë ka në Prizren, ku "Dardanët" fillimisht ndeshen me Zvicrën, më 19 korrik, kurse më pas janë mysafirë të Danimarkës, më 26 korrik dhe 29 korrik ndaj Zvicrës. Ndeshja e fundit do të jetë më 5 gusht ndaj Danimarkës. Vetëm vendi i parë kualifikohet tutje.

SHKURT

Operohet me sukses Kushtrim Gashi

FC Prishtina ka njoftuar se futbollisti Kushtrim Gashi është operuar me sukses pas një lëndimi të pësuar në kampionat ndaj SC Gjilanit si dhe të ripërsëritur po ndaj gjilanasve në finalen e Kupës së Kosovës. Gashi është operuar në këmbë derisa pritet të mungojë disa muaj. FC Prishtina i ka uruar shërim të shpejtë mesfushorit dhe Bardhëkalitri besojnë se lojtari se do të kthehet edhe më i fortë në ekipin kryeqytetas. 30 vjeçari i ishte bashkuar fituesit të Kupës së Kosovës në verën e vitit 2022 nga Ballkani, ndërsa më parë kishte luajtur për Vëllaznimin, Besën dhe Istogun.

Federata e Xhudos pajiset me tatami në vlerë prej 21 mijë eurove

Federata e Xhudos së Kosovës ka bërë të ditur se ka pranuar nga Federata Evropiane e Xhudos 448 m² tatami që ka vlerën e mbi 21 mijë eurove. Ky tatami do të përdoret për Kampionatin e Hapur Evropian të Xhudos që do të mbahet në Kosovë më 16 dhjetor 2023, për herë të parë në histori. "Një falënderim nga zëmra për Federatën Evropiane të Xhudos (EJU) që ka dhuruar 448 m² tatami, me vlerë 21.627.30€ për Kampionatin e Hapur Evropian të Xhudos që do të mbahet në Kosovë më 16 dhjetor 2023, për herë të parë në histori.", thuhet në njoftimin e Federatës së Xhudos.

Italia, kampione e Evropianit në Prishtinë

Italia është kampione e Evropianit U19 për ndeshjet, Divizioni B, të mbajtur në Prishtinë. Të dytën në finalen e madhe, Italia fitoi ndaj Austrisë me rezultat bindës, 29:21. Italia ka shkelqyer gjatë gjithë kampionatit, ndërsa i ka fituar të gjitha ndeshjet. Ka shfaqur nivel të lartë edhe në finale, duke realizuar kushtetë të bukura dhe mbrojtje shumë të fortë. Pjesa e parë ishte më e barabartë, ndërsa në të dytën italianët dominuan plotësisht. Federata e Hendbollit të Kosovës uron Italinë për suksesin e madh në ngjarjen e shkëlqyer të mbajtur për nëntë ditë në kryeqytetin tonë.

Drejtuesit e KOK-ut dhe FFK-së flasin për Lojërat Mesdhetare 'Prishtina 2030'

PRISHTINË, 17 KORRIK - Drejtuesit e KOK-ut, presidenti Ismet Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti, kanë pritur udhëheqësit e Federatës së Futbollit të Kosovës, kryetarin Agim Ademë dhe sekretarin e përgjithshëm, Taulant Hodaj. Palet kanë diskutuar për gjetjen e urave të bashkëpunimit në projekte të ndryshme, me theks të

veçantë Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030". Futbollit është pjesë e programit të Lojërave Mesdhetare, për çka presidenti Krasniqi shpalloi investimet e Qeverisë në përmirësimin e infrastrukturës së futbollit me ndërtime dhe rinovimet e stadumeve tjera. I pari i federatës më të madhe në vend, Agim Ademë, i dha mbështetjeje e plotë drejtuesve të KOK-ut për

organizimin e LM Prishtina 2030, duke mirëpritur investimet në infrastrukturën e futbollit, të cilat i sheh mëse të nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të futbollit tonë. Kosova është kandidate për organizimin e LM Prishtina 2030, ndërsa më 8 shtator 2023 në Heraklion të Greqisë, do të vendoset për organizatorin e kësaj edicioni të Lojërave Mesdhetare.





Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria –Shkup-Government
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
 AGENCIA PËR ARSIM DHE APTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TËRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBLAZOVANJE I POSPOSLOVANJE I OBLAZOVANJE ZA OBLAZLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (X) në Qendrat e Kompetencës për vitin shkollor 2023/2024
 Prishtinë, Qershor 2023

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në Gjimnaz dhe IAAP, për vitin shkollor 2023/24, mund të konkurronjë nxënësit, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.
 Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHD dhe pastaj të konkurronjë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkuruar për regjistrim në klasën e X-të në IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në të cilën shkollën) në të cilën konkurron
- Dëftësen origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për Gjimnaz dhe IAAP s për vitin shkollor 2023/2024, bëhet më datën 18, 19 dhe 20 korrik 2023 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 21.07.2023.

Kritimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 24.07.2023.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) ditë ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve.
 Ankesa prashetohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë behen në Agjencinë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin për të Rritur brenda (2) ditë ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkola.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësit për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- Suksesi nga shkollimi i obliguar (40%) 40 pikë
- Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar (20%) 20 pikë
- Numri i pikëve nga testi (40%) 40 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%), 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksese për gjimnaz dhe shkola të mesme të mjeksisë është qe mesatarja e kotyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (për parillogarit mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat (6-9), pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaz dhe shkola të mesme të mjeksisë është minimum 40% e pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.
 Formula për llogaritjen e pikëve të suksesi është:

$$Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9) \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.
 mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV) = 20 pikë max

Lëndët më prioritet në sukses sipas profileve në IAAP

- Shëndësi, Bujqesi, Teknologji Ushqimore, dhe Veterinari: Biologji, Kimi, Fizikë Gjuhë shqipe dhe letërsi,
- Makinieri, Elektroteknikë, TIK, Tekstili, Gjesodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi — Teknologji, PTT: Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë Matematikë, Informatikë, Fizikë, Gjuhë Shqipe dhe letërsi
- Ekonomi, Administratë: Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi

- Juridik dhe Administratë: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi

- Tregti, Hoteleri dhe Turizëm: Gjuhë shqipe dhe letërsi Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi

- Shkollat Artistike: Gjuhë amtare dhe letërsi Edukatë qytetare, Art, Muzikë

- Drejtimi pedagogjik - profili bashkëpunëtor muzikor: Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar;

- Drejtimi instrumental: Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI); në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI).
 Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë, duhet t'i nënshtrihen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

2. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- Shkollat e Shëndësisë – Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)

$$\frac{mes(Kimi) + mes(Bio\ log\ ji) + mes(Fizikë) + mes(Gjuhë_shqipe)}{4} \geq 4$$

- Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në IAAP

I. Shëndësi, Bujqësi dhe Veterinari

- Shkencat natyrore 25 50 x 0.4 = 20 pikë
 - Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 50 x 0.2 = 10 pikë
 - Matematikë dhe informatikë 25 50 x 0.15 = 7.5 pikë
 - Shkencat shoqërore 25 50 x 0.05 = 2.5 pikë
- Totali = 40 pikë**

II. Makinieri, Elektroteknikë, Gjesodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi - Teknologji

- Matematikë dhe Informatikë 25 50 x 0.4 = 20 pikë
 - Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 50 x 0.2 = 10 pikë
 - Shkencat natyrore 25 50 x 0.15 = 7.5 pikë
 - Shkencat shoqërore 25 50 x 0.05 = 2.5 pikë
- Totali = 40 pikë**

III. Ekonomi

- Matematikë dhe Informatikë 25 50 x 0.4 = 20 pikë
 - Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 50 x 0.2 = 10 pikë
 - Shkencat shoqërore 25 50 x 0.15 = 7.5 pikë
 - Shkencat natyrore 25 50 x 0.05 = 2.5 pikë
- Totali = 40 pikë**

IV. Juridik

- Shkencat shoqërore 25 50 x 0.4 = 20 pikë
 - Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 50 x 0.2 = 10 pikë
 - Matematikë dhe Informatikë 25 50 x 0.15 = 7.5 pikë
 - Shkencat natyrore 25 50 x 0.05 = 2.5 pikë
- Totali = 40 pikë**

V. Tregti, Hoteleri dhe Turizëm

- Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 50 x 0.4 = 20 pikë
 - Shkencat shoqërore 25 50 x 0.2 = 10 pikë
 - Matematikë dhe Informatikë 25 50 x 0.15 = 7.5 pikë
 - Shkencat natyrore 25 50 x 0.05 = 2.5 pikë
- Totali = 40 pikë**

VI. Shkollat Artistike

- Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 50 x 0.4 = 20 pikë
 - Shkencat shoqërore 25 50 x 0.2 = 10 pikë
 - Matematikë dhe Informatikë 25 50 x 0.15 = 7.5 pikë
 - Shkencat natyrore 25 50 x 0.05 = 2.5 pikë
- Totali = 40 pikë**

Mësimi në gjuhën shqipe								
Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr.Nivënieve	Vitet		
Prizren	Qendra e Kompetencës "11 Marsi"	Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit	Dizajn Softwerik	1	24	2+1		
			Telekomunikacionit	1	24	2+1		
			Teknik i sistemeve të TIK	1	24	2+1		
			Trafik rrugor	1	24	2+1		
		Makinieri, Prodhim dhe Nderimtari	Mekatronikë	1	24	2+1		
			Teknik i Elektronikës	1	24	2+1		
			Instalues elektrik	1	24	2+1		
			Automekanik	2	48	2+1		
			INKU - Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit dhe Ujësijtesit	4	96	2+1		
			Metalpunues/Saldues (mësim dual)	1	24	2+1		
			Teknik i dizajnit grafik	1	24	2+1		
			Arhitekturë	1	24	2+1		
			Teknik i izolimit të ndërtesave	1	24	2+1		
			Arte	Dizajn interiori	1	24	2+1	
		Dizajni i tekstilit dhe veshjeve		2	48	2+1		
		Gjithëshj - "11 Marsi"	Gj. shqipe	21	504	2+1		
		Mësimi në gjuhën boshnjake						
		Makinieri, prodhim dhe nderimtari	Arte	Gjithëshj - Gj. Boshnjake	Arhitekturë	1	24	2+1
					Instalues elektrik	1	24	2+1
		Makinieri, prodhim dhe nderimtari	Arte	Gjithëshj - Gj. Turke	Dizajni i tekstilit dhe veshjeve	1	24	2+1
Mekatronikë	1				24	2+1		
Makinieri, prodhim dhe nderimtari	Arte	Gjithëshj - Gj. Turke	Arhitekturë	1	24	2+1		
			Instalues elektrik	1	24	2+1		

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr.Nivënieve	Vitet		
Prishtinë	Qendra e Kompetencës "Shqipëri Gjeçovi"	Makinieri, prodhim dhe nderimtari	Drejtimi kompjuterik i makinave	1	24	2+1		
			Metalpunues	1	24	2+1		
			Automekanik	2	48	2+1		
			Instalues ujësijtesë, ngrohje e klimatizim	3	72	2+1		
			Mekatronikë	1	24	2+1		
			Trafik rrugor	1	24	2+1		
			Transport rrugor	1	24	2+1		
			Drejtesi i trenave	1	24	2+1		
			Dizajni i tekstilit dhe veshjeve	2	48	2+1		
			Shërbime	Arte	Gjithëshj - "Sh. Gjeçovi"	Brazaqçipi	1	24
		Floktari				1	24	2+1
		Makinieri, prodhim dhe nderimtari	Arte	Gjithëshj - "Sh. Gjeçovi"	Estetik	1	24	2+1
					Dizajni i tekstilit dhe veshjeve	1	24	2+1
					Gjithëshj - "Sh. Gjeçovi"	15	384	2+1

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr.Nivënieve	Vitet	
Prizren	Qendra e Kompetencës	Ekonomi, Tregti	Nepunes Finance	1	24	2+1	
			Nepunes industrial	1	24	2+1	
			Nepunes marketingu	1	24	2+1	
			Shërbime ndaj Konsumatorit	1	24	2+1	
			Estetik	1	24	2+1	
		Shërbime	Turizem	Floktari	1	24	2+1
				Udhëheqes i grupeve turistike	1	24	2+1
				Asistent në zyrë informit dhe agjenci turistike	1	24	2+1
		Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Gjithëshj - QK - Prizren	Asistent në organizim e ngjarjeve	1	24	2+1
				Teknik i informatikës së biznesit	1	24	2+1
				10	240		

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr.Nivënieve	Vitet
Skenderaj	Qendra e Kompetencës	Nderimtari e Larë	Beton punues	2	52	2+1
			Ndërtues i konstruksioneve të thata			
			Ngjyrit punues, llak punues			
			Zdrakthetari me punë kulmi			
			Ullamarin punues dhe punues metal			
		Makinieri, prodhim dhe nderimtari	Arhitekturë	1	26	2+1
			Instalues i uji e kanalizimit dhe ngrohje e klimatizim-UK-NK	2	52	
			Instalues elektrik	1	26	
			Muaratori dhe punëtor të ngjashëm	1	26	
			Dizajni i tekstilit dhe veshjeve	1	26	
				8	208	

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	Paralet	Nr.Nivënieve	Vitet	
Malishevë	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi"	Ekonomi, Administrim dhe juridik	Asistent i Administratës	2	48	2+1	
			Banka dhe sigurime	1	24		
			Marketing	2	48		
			Logjistike dhe operim në magazine	1	24		
		Shërbime	Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Asistent hotelier	1	24	2+1
				Teknik për dizajnimin e medieve interaktive	1	24	2+1
		Makinieri, prodhim dhe nderimtari	Art	Instalues elektrik	1	24	2+1
				Instalues ujësijtesë, ngrohje dhe klimatizim	1	24	
		Gjithëshj - QK - "Kujtim Krasniqi" Malishevë	Gjithëshj - QK - "Kujtim Krasniqi" Malishevë	Dizajni i tekstilit dhe veshjeve	1	24	2+1

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr.Nivënieve	Vitet
Ferizaj	Qendra e Kompetencës	Shëndetësi	Babkëpunëtorë Profesional i Infermierisë	1	24	2+1
			As. i Fizioterapisë	1	24	2+1
			Teknik Dentar	1	24	2+1
			Teknik i Farmacisë	1	24	2+1
			Teknik i Optikës	1	24	2+1
			As.Siguria Ushqimore & Dietat	1	24	2+1
			Teknik i Laboratorit Mjekësor	1	24	2+1
			Gjithëshj - QK - Ferizaj	7	168	2+1



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtpërdrejtë të:

- CV-së
- Letërën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshejpte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 ☎ +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Peshter Mining J.S.C" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 810849804 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Peshter Mining J.S.C" D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810849804 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Peshter Mining J.S.C" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810849804 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Bajram Berisha nga Barran i Ulët Pejë shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Valdet Asllani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: 1,2,3,4 të QAMO-s, "Hajdar Dushi", Gjakovë.

Gentiana Isufi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të Gjinnazit "Hajdar Dushi".

- Xhemil Gjini shpall të pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Merlinda Sylja nga Molligji, KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Sh.M. Mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.

- Olti Bajrami shpall të pavlefshme diplomën dhe certifikatën të CMSh QK "11 Marsi" Prizren.

- Florian Hajdaraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Nevruz Gjocaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e QAMO "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Florije Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U. "Shaban Gola Lipovec KK Gjakovë, nga kl. 6-9.

- Valdet Asllani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e QAMO "Nexhmedin Nixha".

- Ibrahim Jakup Brahim shpall të pavlefshme dëftesat e kl. Dhjetë (10) dhe njëmbëdhjetë (11) të Gjinnazit "Ahmet Gashi" Prishtinë.

- Dion Zeqa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m. Muzikës "Prenk Jakova" Gjakovë.

- Ylli Berisha shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së dhjetë (10) të Gjinnazit "Ahmet Gashi" Prishtinë.

- Dion Zeqa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shf.m.u. "Selman Riza" nga kl. 6-9 Gjakovë.

- Jozef Dodaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl.10.11.12 të Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

Lume's Details
Estetik & Depilim

☎ 044 900 978 | 045 687 898

f Sallon Depilimi Lume's Details

📷 lumesdetails

📍 Abropa Teatr itë, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

